



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO			
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS			
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA			
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO			
Pranuar / Dorezuar Prilijeno / Predato Received / Delivery	01.09	3	viti god year
Organ / Njësia Org./Unit	Nr. Prot Bi Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/SHCK	5910/2023		1/6



## Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. Nr.936/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare; Jeton Koca dhe Eshref Shabani, anëtarë; me Ardita Perçuku-Shyti, zyrtare e lartë për bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.936/2023, të datës 07.07.2023, të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit: Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1; nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.6; të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 30.08.2023, njëzëri mori këtë:

### V E N D I M

**I. Anullohet** Raporti i Punës 04a/2023, i Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, lidhur me procedurën e transferimit për shkak të ristrukturimit, për pozitën e punës "Menaxher i ZR Mitrovicë në Departamentin e Koordinimit Rajonal dhe Operativës", Vendimi me numer DM 222/2023, i datës 09.06.202, i Drejtoreshës së Departamentit të Burimeve Njerëzore, të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe Propozimi Nr.KR/25/2023 i datës 09.06.2023 i Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ndërsa, lënda kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* të Komisioni i Ristrukturimit.

**II. Detyrohet** Komisioni i Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore për zbatimin e vendimit sikurse është përcaktuar në pikën I të dispozitivit, duke marr parasysh pikëpamjet juridike të dhëna në arsyetimin e këtij vendimi.

**IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Nëpunësi civil, (tutje vetëm ankuesi), më datë 07.07.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën

A.nr.936/2023, kundër Vendimit me numër DM 222/2023 të datës 09.06.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës administrative dhe Udhëzuesit Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, si dhe për shkak të gabimeve në sistemin e pikëzimit me ç'rast komisioni në bazë të rezultateve të gabuara të vlerësimit/pikëzimit e rendit kandidatin tjetër më lartë për 2,5 pikë duke ia ofruar pozitën e lirë Menaxher i Zyrës Rajonale të AKP-së në Mitrovicë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje Këshilli*), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 11.07.2023, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë, të Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa, kjo e fundit, më datë 13.07.2023, ka përcjell përgjigjen në ankesë, së bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokoli 5674/2023 të datës 15.08.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje edhe për 10 ditë pune lidhur me ankesën A.nr.936/2023 të datës 07.07.2023.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike dhe për vendosje meritore ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokoli 5096/2023 të datës 07.07.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin A.nr.556/2023 të datës 22.05.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër DM 222/2023 të datës 09.06.2023 të Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së; Kërkesën e ankuesit të datës 20.03.2023 përmes e-mailit zyrtar për tek Drejtoreshës së Departamentit për Burime Njerëzore të AKP-së; Komunikimet elektronike të datës 14.03.2023, 09.03.2023 ndërmjet Drejtoreshës së Departamentit për Burime Njerëzore të AKP-së, ankuesit dhe personave gjegjës; Tabelën për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për ankuesin së bashku me shkresat tjera të bashkangjitura; Kërkesën e ankuesit përmes e-mailit zyrtar të datës 20.01.2023 për tek Burimet Njerëzore të AKP-së; E-mailin zyrtar të datës 18.01.2023 nga Burimet Njerëzore të AKP-së për HR; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 11.07.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ; Përgjigjen në ankesë të datës 13.07.2023 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Vendimin me Nr.Ref.BD-173/3 të datës 30.11.2022 të zëvendës Kryesueses së Bordit të Drejtorëve në AKP; Organogramin e AKP-së; Akt emërimit të ankuesit me referencë 155/DMMPI 8 të datës 29.12.2022; Vendimin me numër DM 1118/2022 të datës 14.12.2022 të Drejtoreshës së Departamentit të Burimeve Njerëzore të ATK-së; Vendimin me numër DM 37/2023 të datës 14.02.2023 të Drejtoreshës së Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së; Njoftimin përmes e-mailit zyrtar të datës 23.12.2022 nga Burimet Njerëzore për ankuesin; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatët B.B, F.M, D.B, N.K dhe A.K; Raportin e punës 04/2023 të Komisionit të Ristrukturimit; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për ankuesin lidhur me vjetërsinë e nëpunësit në shërbimin civil, kualifikimet profesionale dhe listën e trajnimeve dhe poentimit për trajnime; Komunikimet elektronike të datës 16.02.2023, 15.02.2023, 14.02.2023 ndërmjet ankuesit dhe Burimeve Njerëzore; Memorandumin e brendshëm të datës 16.02.2023 lidhur me pëlqimin për pranimit të pozitës së ofruar nga Komisioni i Ristrukturimit; Vendimin me numër DM 73/2023 të datës 27.02.2023 të

Drejtoreshës së Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së; Komunikimet elektronike të datës 14.03.2023, 09.03.2023 ndërmjet ankuesit dhe zyrtareve të AKP-së; Kërkesën e ankuesit përmes e-mailit zyrtar të datës 20.03.2023, 09.03.2023 dhe 14.03.2023 ndërmjet ankuesit dhe Burimeve Njerëzore; Vendimin me numër A.nr.556/2023 të datës 22.05.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresën zyrtare të datës 13.06.2023 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit lidhur me zbatimin e vendimit të Këshillit; Raportin e punës 04a/2023 të datës 08.06.2023 të Komisionit të Ristrukturimit; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin D.B lidhur me vjetërsinë e nëpunësit në shërbimin civil, kualifikimet profesionale dhe listën e trajnimeve dhe poentimit për trajnime; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidaten B.B lidhur me vjetërsinë e nëpunësit në shërbimin civil, kualifikimet profesionale dhe listën e trajnimeve dhe poentimit për trajnime; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin F.M lidhur me vjetërsinë e nëpunësit në shërbimin civil, kualifikimet profesionale dhe listën e trajnimeve dhe poentimit për trajnime; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidaten N.K lidhur me vjetërsinë e nëpunësit në shërbimin civil, kualifikimet profesionale dhe listën e trajnimeve dhe poentimit për trajnime; Tabelat për sistemin e pikëzimit për vlerësimin e performances, përvojës, kualifikimeve dhe trajnimeve për kandidatin A.K lidhur me vjetërsinë e nëpunësit në shërbimin civil, kualifikimet profesionale dhe listën e trajnimeve dhe poentimit për trajnime; Propozimin me Nr.KR/25/2023 të datës 09.06.2023 nga Komisioni i Ristrukturimit; Vendimin me numër DM 222/2023 të datës 09.06.2023 nga Drejtoresha e Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së; Kërkesën e datës 05.06.2023 përmes e-mailit zyrtar nga Burimet Njerëzore për personat gjegjes të AKP-së si dhe Vendimin me numër protokollit 5674/2023 të datës 15.08.2023 të KPMShCK-së lidhur me vazhdimin e afatit të ankesës së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes, konstatoi që lënda të kthehet në *ri-shqyrtim* dhe *rivendosje* të Komisioni i Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, *sepse*:

Nga analizimi i shkresave të lëndës rrjedhë se ankuesi është i punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe se i njëjti sipas Aktit të emërimit me numër reference: 155/DMMPI 8 të datës 29.12.2022, është emëruar dhe ushtron pozitën e punës *Kryesues i Njësisë për Marrëdhënie me Publikun*, në Departamentin e Marketingut, Mrrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët.

Me tej, nga provat çështjes rezultojnë së Bordi i Drejtorëve, të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me Vendimin me Nr.Ref.BD-173/3, të datës 30.11.2022, ka aprovuar Rregulloren Nr.07/2022 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës, në Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe si rezultat i kësaj ka pasur shuarje të disa pozitave dhe ndryshime në përshkrimin e vendeve të punës të disa pozitave si dhe krijim të vendeve të reja të punës, ndërsa, përmes Vendimit DM 1118/2022, të datës 14.12.2022, Drejtori i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, ka themeluar Komisionin e Ristrukturimit për shqyrtimin e mundësisë së sistemimit të çdo nëpunësi civil, si pasojë e miratimit të rregullores së re, i ndryshuar me Vendimin DM 37/2023 të datës 14.02.2023.

Drejtoresha e Burimeve Njerëzore të AKP-së, më datë 23.12.2022, ka njoftuar ankuesin se me rastin e miratimit të Rregullores Nr.07/2022 për Organizimin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve

të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është shuar Departamenti i Marketingut, Marrëdhënieve me Publikun dhe Investitorët, ku si rrjedhojë është shuar edhe pozita e punës "Kryesues i Njesisë për Marrëdhënie me Publikun", të cilën ankuesi ka qenë duke e ushtruar sipas Akt emërimit me numër reference: 155/DMMPI 8, të datës 29.12.2022, ku dhe njëkohësisht ankuesi është informuar se Komisioni i Ristrukturimit konform dispozitave ligjore në fuqi, do të trajtojë mundësinë e sistemimit të ankuesit në një pozitë të lirë ekzistuese.

Duke qenë së me Rregulloren Nr.07/2022 për Organizmin dhe Sistematizimin e Brendshëm të Vendeve të Punës në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, është krijuar një departament i ri gjegjësisht Departamenti i Koordinimit Rajonal dhe Operativës në Mitrovicë, Komisioni i Ristrukturimit duke u bazuar në nenin 13 të Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, lidhur me pozitën Menaxher i ZR Mitrovicë, ka përfshirë në proces të vlerësimit sipas pikëzimit gjashtë zyrtarë, pozita e punës së të cilëve ishte shuar, kurse sipas Raportit të Punës 04/2023 i cili nuk mbanë datë të hartimit, nëpunësit civil të cilit i ishin nënshtruar procesit të vlerësimit sipas pikëzimit ishin vlerësuar: *Nëpunësja civile me inicialet B.B me 50.5 pikë; Nëpunësi civil Veton Hajdini me 48 pikë; Nëpunësi civil me inicialet F.M me 46 pikë; Nëpunësi civil me inicialet D.B me 35.5 pikë; Nëpunësja civile me inicialet N.K me 32.5 pikë si dhe Nëpunësi civil me inicialet A.K me 29 pikë*, duke propozuar që kandidatja me më së shumti pikë, respektivisht nëpunësja civile me inicialet B.B, të transferohet në pozitën Menaxher ZR Mitrovicë në Departamentin e Koordinimit Rajonal dhe Operativës, ndërsa, përmes Propozimit me Nr.KR/25/2023 të datës 09.06.2023, Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar që ankuesi dhe katër kandidat tjerë që nga data 01.10.2023, do të propozohet për transferim në një pozitë tjetër të shërbimit civil të lirë, pasi që, të njëjtit nuk plotësojnë kriteret për asnjë pozitë të lirë, në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe së konform këtij propozimi Drejtoresha e Departamentit të Burimeve Njerëzore ka lëshuar edhe Vendimin DM 222/2023 të datës 09.06.2023, me propozimin që ankuesi nga data 01.10.2023, do të propozohet për transferim në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori në institucionin tjetër shtetëror.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se me rastin e zhvillimit të procedurës së transferimit për shkak të ristrukturimit të institucionit lidhur me pozitën Menaxher i ZR Mitrovicë në Departamentin e Koordinimit Rajonal dhe Operativës, Komisioni i Ristrukturimi ka zbatuar gabimisht dispozitat e Udhëzuesit Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit lidhur me llogaritjet për vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil, vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë, kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë dhe trajnimet sa i përket pjesës së vlerësimit në pikëzimit duke i vendosur të njëjtit 48 pikë apo 2,5 pikë më pak se kandidatja fituese e kësaj pozite, i njëjti shton se me rastin e vlerësimit nga ana e komisionit në fjalë nuk i është vlerësuar periudha sa ka qenë i suspenduar dhe duke mos vlerësuar përvojën e tij si Kryesues i Njesisë së Bujqësisë dhe Pylltarisë edhe përkundër vendimit të Këshillit A 02/23/2011 si dhe vendimit për ekzekutim të Gjykatës Themelore E.Nr.1/11, po ashtu shton se komisioni në fjalë lidhur me përvojën në pozita të ngjashme e ka vlerësuar me 0 pikë, duke mos e marrë për bazë përvojën e tij në menaxhim dhe administrim e as gjatë kohës sa ka qenë si Kryesues i Njesisë për Bujqësi dhe Pylltari dhe se edhe tek pjesa e trajnimeve nuk është vlerësuar me pikë reale ngase i njëjti pretendon se ka pasur trajnim edhe mbi një javë e që është dashur ti vlerësohet dyfishi i pikëve, i njëjti kërkon nga Këshilli ta aprovoj ankesën si të bazuar, ta anuloj vendimin lidhur me emërimin e zyrtares për pozitën në fjalë si dhe ta detyroj AKP-në që ti korrigjoj gabimet në tabelën e pikëzimit të ri, ta njoftoj ankuesin dhe ti ofroj pozitën në të cilën ishte në vlerësim për pozitën e lirë si Menaxher i Zyrës Rajonale të AKP-së në Mitrovicë apo ndonjë pozite të ngjashme ekuivalente.

Kolegji i Këshillit pas analizimit të formularëve të vlerësimit, respektivisht tabelave të poentimit për gjashtë (6) zyrtarëve të përfshirë në procesin e vlerësimit sipas pikëzimit, lidhur me kalkulimin e pikëve perkitazi me kriterin e vjetërsisë së nëpunësit civil në shërbimin civil; rezultateve në punë të nëpunësve civilë; kualifikimeve profesionale të nëpunësve civilë dhe trajnimeve, ka konstatuar se Komisioni i Ristrukturimit nuk ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore lidhur me vlerësimin për secilin kriter, duke zbatuar gabimisht edhe formulat e poentimit të përcaktuara me Udhëzuesin Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit respektivisht Shtojca Nr.1 lidhur me Metodologjinë e Vlerësimit dhe Sistemi i Pikëzimit për Kriteret e Vlerësimit. Rrjedhimisht, nga vlerësimi i provave është konstatuar së ka devijim në kalkulim të saktë të disa kriterëve përfshirë vlerësimin e përvojës së punës, më ç' rast janë bërë vlerësime jo të sakta të përvojës së punës në shërbimin civil, aplikim jo i drejt i vlerësimit për përvojë pune në punë të ngjashme dhe për përvojë pune në punë të njëjtë, si dhe përvoja e punës në shërbim civil është njohur vetëm nga data e hyrjes në fuqi të Ligjit.Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, duke aluduar në një vendim të KPMSHCK pa numër dhe datë.

Përmbledhur si me sipër, Kolegji vlerëson së Raporti i Punës 04a/2023 i Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, është akt administrativ i paligjshëm në kuptim të dispozitave të nenit 52 paragrafit 1 nën paragrafit 1.4 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material"*, ngase raportit në fjalë i mungon arsyetimi dhe se i njëjti është i mangët dhe jo i plotë si dhe nuk përmbush kriteret e nevojshme të arsyeshmërisë sikurse përcaktohet me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht se cilat kanë qenë shkaqet vendimtare gjatë vlerësimit të dosjes së kandidatëve dhe arsyen pse metodologjia e përdorur e poentimit është e zbatueshme në rrethanat e rastit konkret dhe mbi çfarë baze ligjore është mbështetur vlerësimi, andaj, mbi këtë gjendje të fakteve shfuqizohet Raporti i Punës 04a/2023 i Komisionit të Ristrukturimit në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, lidhur me transferimin për pozitën "Menaxher i ZR Mitrovicë, në Departamentin e Koordinimit Rajonal dhe Operativës", si rrjedhojë janë shfuqizuar të gjitha aktet e tjera juridike që ndërlidhen me këtë proces sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij vendimi, ndërsa lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Prandaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit thekson faktin se Komisioni i Ristrukturimit të AKP-së, me rastin e rishqyrtimit dhe rivendosjes në tërësi të lëndës që ndërlidhet me procesin e procedurës së transferimit lidhur me pozitën "Menaxher i ZR Mitrovicë ne Departamentin e Koordinimit Rajonal dhe Operativës", duhet të ndër marrë të gjitha veprimet e nevojshme sipas dispozitave të ligjit material, Rregullores Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil, Udhëzuesit Nr.02/2022 për Procesin e Riorganizimit të Institucioneve Publike dhe Sistematizimin e Nëpunësve pas Ristrukturimit dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të konstatimit të saktë të gjendjes faktike dhe poentimit të kandidatëve ashtu sikurse përcaktohet me rregullat dhe udhëzuesin në fuqi, rrjedhimisht Komisioni i Ristrukturimit duhet të kalkuloj saktë përvojën e punës në shërbim civil, duke marr parasysh që përvoja në shërbim civil të njihet që nga themelimi i shërbimit civil në Kosovë sipas Rregullores se UNMIK-ut Nr.2001/36 për Shërbimin Civil në Kosovë si dhe të marr në konsideratë edhe dispozitat ligjore referuar pezullimi të pozitës në shërbim civil në pajtueshmëri me provat referuar pezullimit


të ankuesit.

Theksuar si më lartë, e duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.936/2023**

Ardita Perçuku-Shyti

  
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Komisionit të Ristrukturimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

